



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit




Qëlloi për vdekje policin dhe më pas vrau veten, prindërit braktisën në morg Aldi Ramën



Djalli ka qenë i vetmuar, pa prindërit afër dhe me shoqëri të keqe



Rrëfihet shoku i Aldi Ramës: Nuk besoj se ka vranë veten, ka pasur plumbë automatiku jo pistoletë! Policia do të mbulojë ngjarjen



I shtrirë dhe i gjakosur në tokë, publikohet fotoja e Aldi Ramës pasi qëlloi veten pas 6 orë arrati nga RENE A




Takimi i Berishës në Durrës, flet qytetari: Jepi gaz, unë i pari do të marr kallashin

Kronikë

Vëllai plagos me kallashnikov vëllain në Lushnjë për motive pronësie, e qëlloi me tre plumba sapo doli nga kasollja e bagëtive! Arrestohet pas disa orë kërkimesh autori

Një 65-vjeçar është plagosur me armë zjarri mëngjesin e sotëm në fshatin Ngurrëz e Vogël në Lushnjë. Ngjarja u regjistrua rreth orës 05:00, ku i plagosur mbeti Faik Veliu, i cili dyshohet se u qëllua me armë nga vëllai i tij, Sami Veliu, i cili pas ngjarjes u largua.



Redaksia

24 Shtator, 07:02 | Përditësimi i fundit: 24 Shtator, 12:08



LUSHNJË- Një plagosje me armë zjarri ka ndodhur mëngjesin e sotëm në Lushnjë, ku vëllai ka qëlluar me kallashnikov ndaj vëllait të tij. Ngjarja ka ndodhur në fshatin Gurrëz të Vogël, ku Faik Veliu, 65 vjeç, është qëlluar me tre plumba nga vëllai i tij Sami Veliu, i cili është arrestuar nga policia pak orë pas ngjarjes.

Faik Veliu ka qenë duke i shërbyer bagëtive dhe kur ka dalë nga dera e kasolles, vëllai i tij Sami Veliu e ka qëlluar më armë zjarri kallashnikov. 65-vjeçari ka marrë tre plumba, një në gjoks e dy në bark. Sipas policisë ngjarja ka ndodhur për motive pronësie, dhe autori u arrestua në një banesë të braktisur, ku ju sekuestrua edhe arma e zjarrit, një kallëp tritoli bashkë me ndezësin dhe fishekë luftarak.



LEXO EDHE:

Dogji barëra në tokën e tij dhe flakët dolën jashtë kontrollit, arrestohet 39-vjeçari në Lushnjë! Në pranga edhe një tjetër, prodhonte dhe shiste kanabis në Fier

I plagosuri është dërguar nga familjarët në spitalin e Lushnjës, ku ka marrë ndihëm e parë dhe më pas është nisur më urgjencë drejt spitalit të Traumës në gjendje të rëndë. Banorët e fshatit shprehen se nuk dinë që të kenë pasur konflikte, ndërkohë që i kanë dhënë ndihmën e parë për të plagosurit.



"Tre krisma dëgjova. Gratë ulërinin, atë po e nxirrte i vëllai tjetër dhe i nipi. Shkova e ndihmova, ishte plagosur një në zemër dhe dy poshtë. E ndihmova me nipa e tij." tha një fqinj.



Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 10:24

Zbardhet plagosja në Lushnjë, policia: Vëllai qëlloi vëllain për motive pronësie! Autori u kap në një banesë të braktisur, i gjendet arma, tritol dhe fishekë

Kanë dalë pamjet e arrestimit të Sami Velikut, i cili plagosi mëngjesin e sotëm vëllain e tij me kallashnikov. Policia thotë se plagosja ka ndodhur për motive pronësie.

Sipas policisë shtetasi Faik Veliu, rreth orës 05:00, ka dalë jashtë banesës për t'u kujdesur për bagëtitë e tij dhe është qëlluar me armë zjarri automatik nga largësia nga një person të cilin ai nuk arriti ta shikonte.

Autori Sami Veliu, u largua nga vendngjarja dhe u fsheh në një banesë të braktisur në fshatin Ngurrëz e Vogël, ndërkohë që u prangos nga efektivët dhe iu sekuestrua arma e zjarrit si dhe një kallëp tritoli bashkë me ndezësin dhe fishekë luftarak.

Nga tërësia e veprimeve hetimore rezulton se shtetasi Sami Veliu ka qëlluar me armë zjarri kundrejt vëllait të tij për motive pronësie.

Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Lushnjë, në përfundim të veprimeve hetimore arrestuan për veprat penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese" e mbetur në tentativë dhe "Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak" shtetasin Sami Veliu.

Materialet do i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, për veprime të mëtejshme.



M.Q./Shqiptarja.com

TAG:

plagosje me arme zjarri

lushnje

Faik Veliu

Sami Veliu

Ndalohe repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

Lëvizjet e Berishës e Kadillit, a po përçahet Partia Demokratike?

Po

Jo

Nuk kam mendim

Komento

Lajme të tjera

Sociale



Pritet të ketë prezencë të reshjeve të shiu, parashikimi i motit për ditën e sotme

29 Shtator, 07:20


Kronikë



Vlorë, plagosi me armë zjarri të dashurën në lokal se nuk pranoi ndarjen, burg për 30-vjeçarin: Jam i penduar, i kërkoj falje familjes së vajzës

28 Shtator, 10:09


Kronikë



Vranësira dhe reshje shiu në të gjithë vendin, njihuni me parashikimin e motit për sot

28 Shtator, 07:32

Kronikë



Vranësira dhe reshje shiu në zonat veriore e qendrore, ja si parashikohet moti për ditën e sotme

27 Shtator, 07:35

Kronikë



Tërhoqi zvarrë të renë në mes të lokalit në Vlorë dhe mbante me vetë pistoletë e 2 granata, zbardhet dëshmia e 30-vjeçarit: Doja ta trembja, jo ta qëlloja

26 Shtator, 16:40

Kronikë



Armë të hedhura në shtëpinë e pabanuar, fëmijët gjejnë 2 kallashnikovë në Pogradec

26 Shtator, 16:06

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju